

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Champions League në Top Channel/ Vendos goli i Odegaard, Arsenal mund Napolin në transfertë dhe merr tre pikët e para (Video)
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/09/live-champions-league-ne-top-channel-spektakel-ne-maradona-arsenali-kerkon-tre-piket-ne-transferten-e-napolit/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 18:57:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	9 shtator 2026, 18:53:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 9 shtator 2026, 18:52:00 UTC → 9 shtator 2026, 18:54:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c7f89427aa87627b3fd3b1c9dab5e1678768be6515f44838c94f33ea732960f1
TEKSTI	7784a671bd49bf290dba81661ac37a0926d10f476a441218580de2312c6172a2
PAMJA	6b2bcd4f488d9e011ee98472ce0b386beaddc603f86e49c9f55434bb0fb87d9c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0f7e32bbe673caba278e0d664390a7a3150928dade4efa2c78c322a219ac28e5
E MËPARSHMJA	c69c29259dc75fa956b70afe469cef5542c58b452733f9d97110f103ac8482fa
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0f7e32bbe673caba278e0d664390a7a3150928dade4efa2c78c322a219ac28e5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Lajme](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Pop News](#)
- [Programe](#)
- [Youtube](#)
- [Top News LIVE](#)

Accessibility options



- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Video](#)
- [Programe](#)
- [Lajme](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

[Champions League](#) [Kryesore](#) [Sport](#) [Të Fundit](#)

Champions League në Top Channel/ Vendos goli i Odegaard, Arsenal mund Napolin në transfertë dhe merr tre pikët e para (Video)

09/09/2026 22:56



Arsenal e nis me fitore aventurën në Champions League. “Topçinjtë” triumfuan 1-0 në transfertë ndaj Napolit në stadiumin “Diego Armando Maradona”, në një sfidë të luftuar deri në minutat e fundit.

Ndeshja, e transmetuar drejtpërdrejt në Top Channel, u vendos në pjesën e dytë nga një gol i Martin Odegaard. Kapiteni i Arsenalit provoi një gjuajtje nga distanca në minutën e 75-të, me topin që fillimisht u përplas në shtyllë dhe më pas përfundoi në rrjetë.

Një gol që i dha skuadrës së Mikel Artetës tre pikë të çmuara në një nga transfertat më të vështira të kësaj faze të Champions League.

Napoli dhe Arsenal e nisën sfidën me ritëm të lartë, ndërsa të dyja skuadrat patën mundësi për të zhbllkuar rezultatin.

Kevin De Bruyne provoi në minutën e 15-të me një gjuajtje nga hyrja e zonës, por David Raya ishte në vendin e duhur për ta ndaluar.

Arsenal iu afrua golit në minutën e 22-të, kur Eze hodhi një top në zonë dhe Merino goditi me kokë, por Meret reagoi mirë.

Rasti më i mirë i pjesës së parë për miqtë erdhi në minutën e 45-të. Saka mori një top në zonë dhe doli përballë Meret, por nuk arriti të godiste siç duhet.

Pas 45 minutash, rezultati mbeti 0-0.

Në pjesën e dytë, Arsenali u shfaq më këmbëngulës dhe kërkoi më shumë portën e Napolit.

Rice provoi nga distanca në minutën e 63-të, por gjuajtja e tij përfundoi mbi kuadrat.

Në minutën e 75-të erdhi momenti vendimtar. Odegaard mori përsipër goditjen nga distanca dhe tentativa e tij u përplas në shtyllë. Topi më pas mori drejtim drejt rrjetës, duke i dhënë Arsenalit avantazhin 0-1.

Napoli u përpoq të reagojë në minutat e fundit, por nuk gjeti dot rrugën drejt golit.

Në minutën e 85-të, Madueke pati një mundësi të artë për të dyfishuar avantazhin, pasi doli i vetëm përballë portierit. Ai nuk arriti të shënonte dhe më pas pasoi për Tzolis, tentativa e të cilit u bllokua nga mbrojtja.

Në fund, Napoli 0-1 Arsenal.

Me këtë fitore, skuadra e Artetës merr një trepikësh shumë të rëndësishëm në transfertë dhe jep menjëherë një sinjal për ambiciet e saj në Champions League.

Për Napolin e Massimiliano Allegrit, ndërkohë, kjo është një tjetër goditje në një start të vështirë sezonal.

REZULTATI:

NAPOLI 0-1 ARSENAL

Odegaard 75'

NGJARJET KRYESORE:

90+4' Mbyllet sfida me fitoren 0-1 të Arsenal!

90+3' Havertz gjen rrjetën, por goli anulohet për pozicion të parregullt.

85' Madueke del i vetëm përballë portierit, por nuk shënon dot. Më pas pason për Tzolis, tentativa e të cilit përplasat në trupin e mbrojtësit.

75' Gool Arsenal 0-1/ Odegaard provon me një gjuajtje nga distanca, me topin që përplasat në shtyllë dhe më pas shkon në rrjetë. [\(Video\)](#)

63' Rice provon me një gjuajtje nga distanca, me topin që shkon mbi kuadrat.

50' Hincapie merr një top në zonë, por mbrojtësi godet jashtë kuadratit.

46' Nis pjesa e dytë!

45+2' Mbyllet pjesa e parë!

45' Saka merr një top në zonë dhe i vetëm përballë Meret nuk godet dot si duhet.

22' Eze hedh një top me zonë dhe Merino godet me kokë, por Meret arrin ta ndalë.

15' De Bruyne godet në hyrje të zonës, por tentativa e tij ndalet nga Raya.

1' Starton supersfida në "Maradona"!

FORMACIONET ZYRTARE:





Top Channel

[Champions League »](#)



[Video / Tërbohet Okan Buruk, reagimi epik i trajnerit turk të Gallatasarayt, bën xhiron e rrjetit](#)
09/09 23:27



[Nata që ndryshoi gjithçka, Yaya Touré thyen tabunë e madhe në UEFA Champions League](#)
09/09 23:19



[Video/ Liverpools përmbys Atleticon, PSG-ja kampione e nis me festival golash. Mësoni të gjitha rezultatet e mbrëmjes](#)
09/09 22:55



[Lamine Yamal thyen rekordin e Mbappe, shkruan historinë e Champions League në moshën 19-vjeçare](#)
09/09 22:21



[Video/ Barcelona e nis Champions-in me spektakël, shkatërron me pesë gola Feyenoordin në ndeshjen e parë](#)
09/09 20:45



[Gafa e tij ndëshkoi Interin, portieri Martinez: Marr përsipër përgjegjësinë nga gabimet nxjerr mësim](#)
09/09 18:14

[Kryesore »](#)



[Bllokimi i rrugëve nga protestuesit, Rama replikon sërish me “Demokratët Europianë”: A do kishit mirësinë ta dënonit dhe këtë akt?](#)
09/09 22:59



[Video/ Liverpools përmbys Atleticon, PSG-ja kampione e nis me festival golash. Mësoni të gjitha rezultatet e mbrëmjes](#)
09/09 22:55



[Tre liderët e fuqive më të mëdha globale në një samit? Kremli: Takimi Trump-Putin-Xi në Kinë është i mundur të ndodhë](#)
09/09 22:32



[Studio Champions League në Top Channel/ “I kishte flokët si Ruud Gullit”, Tare dhe Bushi batuta me Lalën: Ky as tani...](#)
09/09 22:16



[Panik tek ukrainasit/ Aeroplani i Zelenskyt i shpëton sulmit me dron në Moldavi, ishte nisur drejt funeralit të mbretit norvegjez Harald V](#)
09/09 21:43



[Video/ Vijnë bllokimi i akseve në Tiranë nga protestuesit, disa prej tyre ulën këmbëkryq para autobusit në “Rrugën e Elbasanit”](#)
09/09 21:35

[Sport »](#)



[Video / Tërbohet Okan Buruk, reagimi epik i trajnerit turk të Gallatasarayt, bën xhiron e rrjetit](#)
09/09 23:27



[Nata që ndryshoi gjithçka, Yaya Touré thyen tabunë e madhe në UEFA Champions League](#)
09/09 23:19



[Video/ Liverpools përmbys Atleticon, PSG-ja kampione e nis me festival golash. Mësoni të gjitha rezultatet e mbrëmjes](#)
09/09 22:55



[Foto/ Historia shkruhet në Turqi, 22-vjeçarja seksi emërohet trajnere e skuadrës së meshkujve](#)
09/09 22:42



[Lamine Yamal thyen rekordin e Mbappe, shkruan historinë e Champions League në moshën 19-vjeçare](#)
09/09 22:21



[Studio Champions League në Top Channel/ “I kishte flokët si Ruud Gullit”, Tare dhe Bushi batuta me Lalën: Ky as tani...](#)
09/09 22:16

Na ndiqni:

[Top Channel](#) [Top Channel - Sport](#) [@topchannelalbania](#) [Top Channel](#)

[Video »](#)



[Top Channel/ “Shitet Qeveria”! Bllokime rrugësh, konflikte dhe brohoritma gjatë protestës së 102](#)



[Top Channel/ “U sulmua avioni i Zelenskyt”, Kryeministri norvegjez: Për pak u rrëzua](#)



[Top Channel/ Trump: Putin do marrëveshje, por e urren Zelenskyn](#)



[Top News- Lamtumira e Mbretit Harald V! 240 mijë veta në rrugët e Oslos për të përcjell monarkun](#)



[Top Channel/ Përshkallëzohet protesta, bllokohen rrugët në Tiranë](#)



[Top News- Shënjestrohet me dron avioni i Zelenskyt, lideri i Ukrainës rrezikon jetën në Moldavi](#)

Sport • KRYESORE



[Video/ Barcelona e nis Champions-in me spektakël, shkatërron me pesë gola Feyenoordin në ndeshjen e parë](#)



[Studio Champions League në Top Channel/ “I kishte flokët si Ruud Gullit”, Tare dhe Bushi batuta me Lalën: Ky as tani...](#)



[Video/ Liverpools përmbys Atleticon, PSG-ja kampione e nis me festival golash. Mësoni të gjitha rezultatet e mbrëmjes](#)



[“Ky ishte futboll i vërtetë”/ Seedorf i mahnitur nga spektakli në Real Madrid-Inter: Nuk mbaj mend të jem kënaqur kaq shumë që nga...](#)

Me të lexuarat

[Vëllai i Mbappe shkatërron debutimin në Champions League të Davide Ancelottit, ndërhyrje edhe...Kylian](#)

[Opta parashikon fituesin e Champions League, ja 10 skuadrat favorite. Befasi në listë](#)

[Video/ Barcelona e nis Champions-in me spektakël, shkatërron me pesë gola Feyenoordin në ndeshjen e parë](#)

[“Ky ishte futboll i vërtetë”/ Seedorf i mahnitur nga spektakli në Real Madrid-Inter: Nuk mbaj mend të jem kënaqur kaq shumë që nga...](#)

[Foto/ “Shitet kështjella” me çmimin e 100 milionë dollarëve, pas 10 ditësh në treg, ndodhet në duart e...](#)

[View Lajme e fundit nga Top Channel/ Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.](#)

[Champions League në Top Channel/ Vendos goli i Odegaard. Arsenal mund Napolin në transfertë dhe merr tre pikët e para \(Video\)](#)
[Galatasaray luan në Champions. Leao thëmbon Milanin në konferencën për shtyp](#)
[Krahu i djathtë në alarm te Kombëtarja. Maran zbarkon në Skoci për të gjetur "sallaks". Një shkodran është risia për ndeshjet e radhës](#)
[Përplasja me Lautaro Martinez dhe 'mesazhi' për Barellan. Huijsen ndez rrjetet sociale dhe juventinët...](#)
[Studio Champions League në Top Channel/ "I kishte flokët si Ruud Gullit", Tare dhe Bushi batuta me Lalën: Ky as tani...](#)

- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)
- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)
- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)
- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)
- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)
- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.